

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MATURA SHTETËRORE PROFESIONALE

MODEL TESTI

KUALIFIKIMI PROFESIONAL "HOTELERI - TURIZËM"

Prill 2024

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsytim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Forma më bashkëkohore e komunikimit me konsumatorin në industrinë hoteliere është: **1 pikë**
A) E-marketingu.
B) shkresat zyrtare.
C) ballë për ballë.
D) raportet zyrtare.
2. Cila nga karakteristikat e mëposhtme i përket hoteleve të vogla? **1 pikë**
A) Kanë një kapital të madh investimi dhe financiar.
B) Drejtohen nëpërmjet një menaxheri të përgjithshëm.
C) Kanë një strukturë të burimeve njerëzore me drejtim vertikale.
D) Kanë një organizim kompleks të burimeve materiale, financiare dhe njerëzore.
3. Sa do të jetë kosto e mallrave të shitur në barin e hotelit, në qoftë se gjendja fillestare e mallrave në fillim të muajit ishte po njësoj sa gjendja përfundimtare, si dhe blerjet gjatë muajit ishin 100.000 lekë? **1 pikë**
A) 50.000 lekë
B) 100.000 lekë
C) 150.000 lekë
D) 200.000 lekë
4. Cili nga dokumentet e mëposhtme **NUK** përdoret në zyrën e recepsionit? **1 pikë**
A) Libri i hyrje - daljeve të klientëve
B) Lista e blerjeve për lëndën e parë
C) Grafiku i dhomave të zëna
D) Grafiku i orëve të punës për personelin
5. Cili/cila nga personeli më poshtë është pjesë e personelit të administratës në një hotel:? **1 pikë**
A) Shefi/ja i portinerisë
B) Shefi/ja e recepsionit
C) Shefi/ja e burimeve njerëzore
D) Shefi/ja e kateve
6. Sektorët që sigurojnë produkte dhe shërbime që nuk mund të shiten në një hotel quhen: **1 pikë**
A) sektorë kryesorë
B) sektorë tregtarë
C) sektorë ndihmës
D) sektorë plotësues
7. Paga minimale aktualisht në Republikën e Shqipërisë është: **1 pikë**
A) 20 000 lekë
B) 22.000 lekë
C) 26 000 lekë
D) 30.000 lekë
8. Plotëso vendin bosh me alternativën e saktë:
..... është procesi i arritjes së objektivave organizative duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve dhe burimeve të tjera organizative. **1 pikë**
A) Sipërmarrja
B) Menaxhimi
C) Marketingu
D) Informimi

9. Funkzioni si proces i ndikimit social, gjatë të cilit një person, duke siguruar ndihmën dhe mbështetjen e të tjerëve, i drejton ata drejt realizimit të një detyre të përbashkët është: **1 pikë**
- A) planifikimi
 - B) organizimi
 - C) udhëheqja
 - D) kontrolli
10. Gatishmëria e një individi në përpjekje për të arritur objektivat e sipërmarrjes, duke vënë në përdorim një sasi të madhe energjish dhe përpjekjesh, me qëllim plotësimin e objektivave të tij individuale quhet: **1 pikë**
- A) rekrutim
 - B) trajnim
 - C) zhvillim
 - D) motivim
11. Baza e aktiviteteve të marketingut është e përqendruar në katër elemente tradicionale, të njohura si 4 P-të e marketingut. Cili nga elementët e mëposhtëm nuk është pjesë e tyre? **1 pikë**
- A) Produkti
 - B) Vendi
 - C) Promocioni
 - D) Plani
12. Cila alternativë shpreh saktë ndërhyrjen e qeverisë në ekonominë e një vendi? **1 pikë**
- A) Ka rënë rëndësia e sektorit publik
 - B) Shpenzimet qeveritare nuk ndikojnë në sektorin privat
 - C) Shpenzimet qeveritare në të gjitha nivelet kanë qenë në rritje
 - D) Taksat dhe shpenzimet qeveritare kanë ndikim të vogël në ekonomi
13. Rritja e përgjithshme e ofertës monetare në një ekonomi të caktuar në një periudhë të caktuar quhet: **1 pikë**
- A) punësim
 - B) inflacion
 - C) deflacion
 - D) rritje ekonomike
14. Cili nga elementët e mëposhtëm **NUK** është karakteristikë e ofertës turistike? **1 pikë**
- A) Elasticiteti
 - B) Sezonaliteti
 - C) Ngurtësia
 - D) Kapaciteti mbajtës
15. Në ekonominë e tregut funksionet kryesore bashkërenduese të subjekteve ekonomike i kryen: **1 pikë**
- A) shteti
 - B) tregu
 - C) individi
 - D) shoqëria
16. Cili nga faktorët e mëposhtëm **NUK** ndikon në ndryshimin e madhësisë dhe tipit të kërkesës turistike? **1 pikë**
- A) Demografia e popullsisë
 - B) Situata sociale dhe politika e vendit
 - C) Sistemi i pagave dhe i çmimeve
 - D) Shpenzimet në infrastrukturë
17. Bazuar në rregullat e funksionimit të llogarive, cili nga veprimet e mëposhtme **NUK** regjistrohet në debi? **1 pikë**
- A) Pakësimi i një aktivi
 - B) Pakësimi i një detyrimi
 - C) Pakësimi i kapitalit të pronarit
 - D) Pakësimi i të ardhurave

- 18.** Llogaria shërben për: **1 pikë**
- A) regjistrimin kronologjik të veprimeve ekonomike
 - B) regjistrimin e të gjitha veprimeve ekonomike me natyrë homogjene
 - C) regjistrimin e efekteve të veprimeve ekonomike
 - D) regjistrimin e dokumenteve kontabël

- 19.** Tregoni se cili nga veprimet e mëposhtme është e ardhur? **1 pikë**
- A) Arkëtimi nga shitja e makinerisë
 - B) Arkëtimi i kredisë së marrë
 - C) Arkëtim nga shitja e mallrave
 - D) Arkëtimi i parave nga klienti

- 20.** Raporti i likuiditetit është tregues i rëndësishëm që shërben si burim informacioni për: **1 pikë**
- A) kreditorët
 - B) klientët
 - C) investitorët
 - D) aksionerët

- 21.** Rendit 4 dokumente teknike që i referohen informacioneve të përmbledhjes së veprimtarisë ekonomike të strukturave akomoduese: **4 pikë**
- 1. _____
 - 2. _____
 - 3. _____
 - 4. _____

- 22.** Rendit tri qëllime kryesore të planifikimit të sektorit të kuzhinës: **3 pikë**
- 1. _____
 - 2. _____
 - 3. _____

- 23.** Për të realizuar detyrat e tij në strukturën akomoduese, receptionisti duhet të dijë në çdo moment të ditës disa të dhëna. Renditni tri prej tyre: **3 pikë**
- 1. _____
 - 2. _____
 - 3. _____

- 24.** Ndërto strukturën organizative në strukturat e mëdha akomoduese. **3 pikë**
- 1. Ndërtimi i skemës
 - 2. Emërtimi i skemës
 - 3. Lidhja e skemës

- 25.** Renditni duke përshkruar tri prej karakteristikave më të rëndësishme të një komunikimi të efektshëm në biznes: **3 pikë**
- 1. _____
 - 2. _____
 - 3. _____

26. Menaxhimi i riskut ndjek si logjikë tri etapa. Renditini duke i përshkruar ato:

3 pikë

1. _____
2. _____
3. _____

27. Nga pasqyrat financiare të shoqërisë "A&B", për vitin 2020 kemi shkëputur informacionet e mëposhtme:

3 pikë

Kapitali i huazuar (detyrimet) 250.000 lekë
Kapitali i vet 500.000 lekë
Fitimi 100.000 lekë

Bazuar në të dhënat e aktivitetit të shoqërisë kërkohet të llogarisni treguesit financiarë të mëposhtëm:

- a) Kthimi nga kapitali i vet
- b) Kthimi nga investimi
- c) Raporti i borxhit

28. Rendit faktorët që ndikojnë në ndryshimin e madhësisë dhe tipit të kërkesës turistike.

3 pikë

1. _____
2. _____
3. _____

29. Evidentoni veçoritë ku qëndron marrëdhënia midis turizmit dhe zhvillimit të qëndrueshëm:

3 pikë

1. _____
2. _____
3. _____

30. Rënditni tri efektet pozitive të përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në aktivitetin hotelier. **3pikë**

1. _____

2. _____

3. _____

31. Në lidhje me pagat e punonjësve në shoqërinë "T&T" zotërohet ky informacion nga lista e pagave në fund të muajit:

Pagat gjithsej	400.000 lekë
Sigurimet shoqërore	44.800 lekë
Tatimi mbi të ardhura personale	12.000 lekë

Kërkohet:

3pikë

1. Të llogaritet Totali i Pagave Neto.
2. Të regjistrohet në ditar pagesa e Pagave Neto
3. Të regjistrohet në llogari në formë T-je veprimi i mësipërm.

32. Janë marrë këto të dhëna në fund të veprimtarisë ushtrimore:

Kostot e shitjeve	250.000 lekë
Të ardhurat nga investimet	100.000 lekë
Të ardhurat nga shitjet	600.000 lekë
Shpenzime për interesa	30.000 lekë
Personeli	300.000 lekë
Reklama	20.000 lekë

Kërkohe:

3 pikë

1. Të ndërtohet pasqyra horizontale e të ardhurave dhe shpenzimeve.
2. Të llogaritet fitimi ose humbja.
3. Të llogaritet raporti i fitimit mbi shitjet,

33. Është dhënë pasqyra e Bilancit Kontabël në fund të periudhës së veprimtarisë ushtrimore për një ndërmarrje turistike:

Aktive	Shuma (në lekë)	Pasive	Shuma (në lekë)
Mjete monetare	200.000	Detyrime afatshkurtra	50% e aktiveve afatshkurtra
Materiale	300.000	Kredi afatgjatë	400.000
Makineri	500.000	Totali i Detyrimeve	?
Ndërtesa	800.000	Kapitali i pronarit	?
Totali i aktiveve	?	Totali i pasiveve	1.800.000

Kërkohet:

3 pikë

1. Të llogaritet Totali i Aktiveve
2. Të llogaritet Totali i Detyrimeve
3. Të llogaritet Kapitali i Pronarit